



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 218/1 Prot

Tiranë, më 29.03.2022

V E N D I M

Nr.43, datë 29.03.2022

Mbi vlerësimin e procesit administrativ të njohjes së statusit të nëpunësit civil në përfundim të periudhës njëvjeçare të provës, për nëpunësen *** të Bashkisë Durrës, e cila ndërkohë ka kryer dhe lejen e barrë lindjes.**

Në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, mbi bazën e relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të mbledhur në kuadër të verifikimit të çështjes,

VËREJ SE:

Nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr. 1078, datë 13.12.2021, dërguar nga punonjësja ***** , është kërkuar mbështetje ligjore për t’u qartësuar nëse e ka fituar titullin e “nëpunësit civil” në fund të periudhës një vjeçare të emërimit në shërbimin civil në periudhë prove, nisur nga fakti se gjatë kësaj periudhe ka kryer edhe lejen e barrë lindjes.

Pas shqyrtimit të të dhënave që përmbante informacioni i përcjellë, si dhe pas administrimit të dokumentacionit të ardhur nga Bashkia Durrës nëpërmjet shkresës nr. 25/1 prot., datë 17.01.2022 “Kthim përgjigje”, konstatohet se punonjësja ***** , është pranuar në shërbimin civil, pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, me aktin nr. 3085 prot., datë 03.3.2020 “Akt emërimi në detyrë”, në pozicionin “Specialiste e protokoll-arkivës” në Bashkinë Durrës.

Rezulton se 2 muaj e 20 ditë pas emërimit në detyrë, nëpunëse civile në periudhë prove, në datën 25.05.2020 nëpunësja ka ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkak të marrjes së lejes së barrëlindjes prej nga duhej të ishte kthyer në punë në datën 21.04.2021.

Konstatohet gjithashtu, se menjëherë pas përfundimit të raportit mjekësor, në datën 22 prill 2021, me kërkesë të saj, punonjëses i është dhënë një leje pa të drejtë page.

Ndërkohë, gjatë periudhës së raportit mjekësor të barrëlindjes, në datat 08-15 Shtator 2020, nëpunësja në fjalë, në përmbushje të detyrimit ligjor të përshkruar në pikën 2, të nenin 24, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka marrë pjesë dhe ka përfunduar me sukses trajnimin e detyrueshëm *on-line* në ASPA, duke u pajisur me çertifikatën përkatëse.

Në përfundim të periudhës së barrëlindjes dhe lejes pa të drejtë page, në datë 5 korrik 2021 (pas 13 muaj e 10 ditë kalendarike gjithsej) nëpunësja është rikthyer në detyrë, në pozicionin e saj “Specialiste e protokoll-arkivës” në Bashkinë Durrës, duke pretenduar se tashmë e kishte plotësuar periudhën e provës dhe mund të konsiderohej se e kishte përfituar statusin e nëpunësit civil. Këtë pretendim të saj, njësia përgjegjëse e ka përmbyllur me aktin nr. 13492 prot., datë 22.12.2021, duke vendosur konfirmimin e saj si nëpunëse civile.

Lidhur me vlerësimin e veprimeve si më sipër, sqarojmë sa më poshtë:

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar, rezulton se nga momenti i emërimit, data 03.3.2020, deri në ditën e paraqitjes në detyrë pas periudhës së paafëtisë, në datën 05.7.2021, punonjësjë ***** ka kryer realisht detyrën si “Specialiste e protokoll-arkivës” në Bashkinë Durrës, vetëm për 2 muaj e 20 ditë.

Në kushtet kur ajo është nëpunës civil i emëruar për herë të parë në shërbimin civil, në nivel ekzekutiv, duhet ti nënshtrohet një periudhe prove, që zgjat një vit nga data e emërimit. Bazuar në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe në kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, gjatë kësaj periudhe nëpunësi vihet nën kujdesin e një tjetër nëpunësi me eksperiencë në shërbimin civil dhe është i detyruar të ndjekë e të përfundojë me sukses, programin e trajnimit pranë ASPA.

Në rastin konkret, nisur nga përmbajtja e aktit nr. 13492 prot., datë 22.12.2021, të njësisë përgjegjëse të Bashkisë Durrës, për konfirmimin e shtetases ***** si nëpunëse civile në pozicionin “Specialiste e protokoll-arkivës” në Bashkinë Durrës, evidentohet fakti që kushti i vënë për plotësimin e kohëzgjatjes të periudhës së provës për një vit, nuk është respektuar, gjë e cila bën që akti i mësipërm të jetë një akt i kundraligjshëm, pasi është nxjerrë në kundërshtim me pikën 1, të nenit 24, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe si i tillë, në bazë të pikës d), të nenit 109, të ligjit nr. 44/2014 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, përbën shkak për anulimin e tij.

Njësia përgjegjëse e Bashkisë Durrës, ka gabuar për faktin që kohën e zgjatjes së lejes së barrëlindjes, e ka konsideruar si pjesë përbërëse të periudhës së provës.

Leja e barrëlindjes është një e drejtë e veçantë në marrëdhëniet e punës, e cila lidhet me plotësimin e një funksioni apo detyre social-natyrore, që nuk lidhet drejtpërdrejt me punën apo me ushtrimin e profesionit. Në këtë mënyrë perceptohet kjo e drejtë edhe në përmbajtjen e Vendimit nr. 568, datë 06.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit, orët shtesë...*”.

Konkretisht, në pikën 6, të Kreut III, të vendimit në fjalë, jepet mënyra si duhet të llogaritet periudha e lejes së barrëlindjes, në raport me llogaritjen e pushimit vjetor të paguar, duke e formuluar në këtë mënyrë: “*Në rastet kur i punësuar, brenda vitit kalendarik, ka kryer lejen e barrëlindjes, kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar llogaritet në përpjestim të drejtë me kohëzgjatjen efektive të punës pa përfshirë periudhën e kësaj leje*”.

Kjo mënyrë llogaritje, tregon se leja e barrëlindjes, si një e drejtë e llojit të veçantë, e cila rregullohet nga legjislacioni përkatës, nuk barazohet me kohën efektive të kryerjes së detyrës në të cilën nëpunësi është emëruar e, në këtë linjë, koha e barrëlindjes nuk mund të konsiderohet pjesë integrale e periudhës së provës.

Në rastin konkret, paraqitja e nëpunëses ***** në detyrë, në datën **5 korrik 2021**, do të shënonte edhe fillimin e vazhimit, të plotësimin të afatit të periudhës një vjeçare të provës, për kohën e mbetur (*pasi të zbriteshin 2 muaj e 20 ditë, që ishin kryer*).

Vetëm pas plotësimin të afatit të periudhës së provës, sipas mënyrës së llogaritjes së mësipërme, në varësi të performancës së nëpunësit dhe të vijimësisë në punë, eprori direkt ka detyrimin të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë dhe nëse rezultati i vlerësimit është pozitiv, eprori direkt merr vendim i cili i njoftohet njësisë përgjegjëse për të nxjerrë aktin e konfirmimit të nëpunësit civil.

Në rast se në përfundim të afatit një vjeçar efektiv të provës, eprori direkt nuk është i bindur në ecurinë pozitive të nëpunësit, në bazë të pikës 3/b dhe c, të nenit 24 “*Periudha e provës*”, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, ka të drejtë të urdhërojë:

b) zgjatjen e periudhës së provës një herë të vetme, deri në 6 muaj të tjerë, nëse për arsye të justifikuarra ka qenë i pamundur vlerësimi i plotë i nëpunësit;

c) moskonfirmimin e nëpunësit;

Nisur nga aktet, të cilat faktojnë prezencën në detyrë të punonjësës ***** , afati i periudhës së provës, plotësohet në datë **10 prill 2022**, datë e cila do të shënojë fillimin e procesit të vlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe në kreun VI, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë

18.3.2015 “Për pranimin lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Një moment tjetër i zbatimit jo korrekt të legjislacionit të shërbimit civil në këtë rast, është edhe fakti që nëpunëses në fjalë i është dhënë pushim pa të drejtë page, për një periudhë afro tre muaj. Në bazë të pikës 15, të Kreut III, të Vendimit nr. 568, datë 06.10.2021 “Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe pushimit, orët shtesë...etj”, pushimi pa të drejtë page nuk mund të kalojë 30 ditë, brenda të njëjtit vit kalendarik.

Në një eventualitet si rasti i nëpunëses në fjalë, e cila kishte nevojë për më shumë se 30 ditë pushim pa të drejtë page, duhej të ishin përdorur institute të tjera të legjislacionit të shërbimit civil, siç mund të ishte pezullimi, etj.

Nga gjithë sa u thanë më sipër, njësia përgjegjëse, duhet të kryejë veprimet e duhura për anulimin e aktit nr. 13492 prot., datë 22.12.2021 “Akt konfirmimi për statusin e nëpunësit civil”, të nëpunëses në periudhë prove ***** në pozicionin e punës “Specialist arkiv-protokoll” dhe në vijim eprori direkt të plotësojë detyrimet ligjore siç janë përcaktuar më sipër, sapo të konstatohet plotësimi i afatit një vjeçar, efektiv, të periudhës së provës.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Durrës, të të anulojë aktin nr. 13492 prot., datë 22.12.2021 “Akt konfirmimi për statusin e nëpunësit civil”, të nëpunëses në periudhë prove ***** në pozicionin e punës “Specialist arkiv-protokoll” në Bashkisë Durrës.
2. Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Durrës, të organizojë dhe ndjekë procesin e konfirmimit të nëpunëses *****, si nëpunëse civile, në pozicionin “Specialiste e protokoll-arkivës” në Bashkinë Durrës. Konfirmimi të kryhet sipas përcaktimeve të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Kreun VI, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” dhe trajtimit të bërë në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

3. Njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
4. Në rast të mos respektimit të vendimit, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimin dhe në zbatim të përcaktimit të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës, për moszbatimin e masës së përcaktuar në dispozitivin e vendimit.
5. Të njoftohet për këtë vendim, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Durrës dhe punonjësja
*****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha